



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.742/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani, dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Vehbi Rexhepi, sekretar i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Dragash, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 11.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si e pasafatshme ankesa e Vehbi Rexhepi, sekretar i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Dragash, me shenjë ZL.Anr.742/2017 e datës 09.11.2017, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit me datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP, më datë 09.11.2017, ka pranuar një ankesë nga Vehbi Rexhepi, sekretar i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën pretendon se Adem Emmini ka bërë votim të dyfishtë në Vendvotimin 05/02A, ku ka votuar në emër të vëllaut të tij Burim Emmini dhe këtë e ka lejuar komisioneri Ajret Misini.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të afatshmërisë së ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pasafatshme.

Për të gjitha parregullsitë që mund të paraqiten në ditën e votimit, ankesa mund të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit, sipas nenit 119 të LZP-së lidhur me nenin 5 paragrafi 5.3 i Rregullës Nr.02/2015. Në rastin konkret ashtu siç del nga ankesa, e njëjta është pranuar nga PZAP me datën 30.10.2017. Nga përmbajtja e ankesës rezulton se të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara nga ankuesi në ankesën ZL.Anr.742/2017 të datës 09.11.2017, ndërlihet me parregullsitë gjatë procesit të votimit, për ditën e votimit të datës 22.10.2017.

Nga kjo rezulton se ankesa e lartpërmendur është dorëzuar, pasi që ka kaluar afati ligjor për të parashtruar ankesë në PZAP, për parregullsitë në ditën e votimit sipas dispozitës së

lantcekur ligjore, kjo nga fakti se afati për paraqitjen e ankesave ka qenë me datën 23.10.2017 deri në ora 19:00, ndërkaq ankuesi ankesën e ka parashtruar me datë 09.11.2017 në PZAP, që do të thotë se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me nenin 5 paragrafi 5.3, lidhur me nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë ne kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 5 par. 5.3, neni 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.742/2017 më datën 11.11.2017

Kryesuesi i Panelit
Rafet Harxhaj

The image shows a circular official stamp of the Panel for Complaints and Petitions (PZAP). The stamp contains the text "Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia" around the perimeter and "PZAP" in the center. Below the stamp, there is a handwritten signature in blue ink that appears to read "Rafet Harxhaj".

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.